

Alcune informazioni sul virus HPV: informazioni brevi per le utenti

Disa informacione rreth virusit HPV: informacione të shkurtra për përdorueset





Këto informacione u drejtohen veçanërisht grave të ftuara për të bërë një test për zbulimin e virusit HPV (testi HPV) në kuadrin e programeve screening për parandalimin e tumorit të qafës së mitrës.

1. Çfarë është virusi HPV?

HPV (papillomavirusi i njeriut) është një virus që shkakton një infeksion shumë të shpeshtë, që shumica e njerëzve e marrin të paktën një herë gjatë jetës së tyre.

2. Çfarë shkakton ky infeksion?

- ◆ Në përgjithësi nuk shkakton ndonjë ndryshim dhe zhduket vetiu.
- ◆ Në pak raste shkakton dëmtime në nivelin e qafës së mitrës. Shumica e plagëve shërohen spontanisht, por disa, nëse nuk kurohen, përparojnë ngadalë në forma tumoresh.
- ◆ Por megjithatë duhen shumë vite që plagët të transformohen, dhe vetëm te shumë pak gra me infeksion nga papillomavirus zhvillohet një tumor i qafës së mitrës.

3. Sa kohë zgjat infeksioni?

- ◆ Shumica dërrmuese e infeksioneve zhduket spontanisht, rreth 50% gjatë një viti dhe rreth 80% gjatë dy viteve.
- ◆ Kur infeksioni zhduket, gjithashtu edhe rreziku zhduket.

4. Si merret?

- ◆ Merret me rrugë seksuale, megjithëse nuk ndodh medoemos pas një marrëdhënie seksuale të plotë.
- ◆ Në disa raste infeksioni mund të transmetohet nga një person te tjetri edhe pas shumë vitesh pasi njëri prej tyre ta ketë marrë atë.
- ◆ Fakti se jemi infektuar pra mund të mos ketë të bëjë fare me partnerin aktual.

5. Si kurohet?

- ◆ Akoma nuk ka ilaçe për të kuruar këtë infeksion. Veçanërisht, është vërtetuar se nuk shërbejnë antibiotikët, ovulat ose lavazhet vaginale.
- ◆ Gjëja më e rëndësishme, megjithatë, është që të identifikojmë në kohën e duhur ndryshimet e shkaktuara nga virusi, të cilat janë ato që po kërkojmë me Pap-testin, në rastin e një testi HPV pozitiv.
- ◆ Pra, pjesëmarrja në screening është gjëja më efektive që një grua mund të bëjë për të mbrojtur veten.

6. A mund të parandalohet?

- ◆ Është shumë e vështirë për ta parandaluar atë: në fakt është një infeksion shumë i zakonshëm, sidomos tek të rinjtë dhe prezervativi nuk garanton një mbrojtje prej 100%.
- ◆ Ka disa vite që përdoret një vaksinë kundër disa llojeve të viruseve përgjegjës për shumicën e tumoreve të qafës së mitrës.



7. Çfarë është testi HPV dhe si bëhet?

- ◆ Testi HPV është një analizë laboratorike për zbulimin e virusit dhe kryhet në materialin e marrë me një mënyrë shumë të ngjashme me Pap-testin.

8. Pse bëhet testi HPV?

Testi HPV mund të bëhet për disa arsye:

- ◆ Si test screening, në vend të Pap-testit duke filluar nga mosha 30-35 vjeç. Në këtë rast, nëse testi HPV është pozitiv, Pap-testi bëhet një analizë plotësuese, e cila quhet test *triage*, sepse seleksionon gratë që kanë modifikime qelizore dhe që duhet të bëjnë kolposkopinë;
- ◆ Si test triage për të seleksionuar, ndërmjet grave që kanë disa modifikime të qelizave në Pap-test (thërrisni ASC-US ose LSIL), ato që duhet të bëjnë një kolposkopi. Në këtë rast, testi HPV është një analizë plotësuese;
- ◆ Për të ndjekur, me kalimin e kohës, gratë që kanë një test HPV ose një Pap-test pozitiv dhe një kolposkopi negative ose që u kanë dalë në pah plagë të lehta;
- ◆ Për të ndjekur, me kalimin e kohës, gratë që kanë pasur një trajtim për plagët e qafës së mitrës.

9. Çfarë është kolposkopia?

- ◆ Kolposkopia është një kontroll i ngjashëm me vizitën gjinekologjike: gjinekologu përdor një instrument të quajtur kolposkop, i cili shërben për të ndriçuar qafën e mitrës dhe për ta parë atë të zmadhuar.
- ◆ Nëse gjinekologu sheh përqësime, ai bën një biopsi, që është një prelevim (marrje) i vogël i indeve nga qafa e mitrës.
- ◆ Në përgjithësi, kolposkopia nuk është e dhimbshme. Nëse do t'u bënin një biopsi, ka mundësi të ndienit një shqetësim të lehtë, si një pickim ose një dhimbje e lehtë.
- ◆ Nganjëherë pas kolposkopisë mund të ndodhë që të kemi një rrjedhje të vogël gjaku që zakonisht pushon vetvetiu pas pak kohësh.

10. Çfarë do të ndodhë pasi të kemi bërë kolposkopinë?

- ◆ Nëse qafa e mitrës suaj do të rezultojë normale ose do të paraqesë vetëm plagë të lehta, nuk do të keni nevojë për ndonjë kurë të veçantë dhe gjinekologu do t'ju tregojë se cilat kontrole duhet të bëni më vonë.
- ◆ Nëse përkundrazi, gjinekologu do të gjejë plagë që kanë nevojë për një trajtim, ju mund të kuroheni falas pranë një qendre të specializuar në referim me programin screening.

11. Si mund të marr më shumë informacione rreth virusit HPV?

- ◆ Shih *Altre informazioni sul virus HPV: informazioni approfondite per le utenti* (Informacionet e tjera rreth virusit HPV: informacione të hollësishme për përdoruesit) në adresat: www.osservatorionazionalecreening.it ose www.gisci.it.

Gruppo di lavoro


Anna Iossa e Francesca Maria Carozzi (Coordinatori), Angela Brachini, Cinzia Campari, Debora Canuti, Paola Capparucci, Francesca Maria Carozzi, Carmelina Di Piero, Chiara Fedato, Grazia Grazzini, Anna Iossa, Gessica Martello, Cristina Nicolai, Antonella Pellegrini.

Un ringraziamento particolare alle donne che hanno contribuito alla realizzazione di questo progetto:

Cloè Belliot, Lorena Baboçi, Magdalena Ciupercovici, Elise Merrill Chapin, Elena Dascaluic, Ekaterina Egorchenkova, Anna Garasymiv, María Maestre Fernández, Wendy Martin, Eshraga Mohammed Abdalwahap, Meriem Moutiai, Julia Nico e Natascha Pleshca.

Un ringraziamento al gruppo di lavoro delle 100 domande sull'HPV:

Debora Canuti, Francesca Maria Carozzi, Carla Cogo, Annarosa Del Mistro, Carmelina Di Piero, Silvia Franceschi, Cristina Giambi, Paolo Giorgi Rossi, Anna Iossa, Tiziano Maggino, Gessica Martello, Maria Grazia Pascucci.

**Realizzazione editoriale:**

Inferenze Scarl, Milano

La traduzione dall'italiano alle altre lingue è stata realizzata da:

STUDIO TRE S.r.l., Reggio Emilia

Progetto grafico e impaginazione:

Giovanna Smiriglia (Studio Impronte - Milano)